



Pranuar / Dorezuar Priljezja / Predaja Received / Delivery	16.09.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtetja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHICK	5335/2022		116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.645/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.645/2022 të datës 21.07.2022 të parashtruar nga të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë

kundër Përgjigjes së datës 12.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.09.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me kërkesën e ankueses me numër protokoll 2021/DSF/138 të datës 23.04.2021.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 23.12.2016 në pozitën Zyrtare e Aviacionit të Përgjithshëm në Departamentin e Sigurisë së Fluturimeve, më datën 23.04.2021 ka bërë kërkesë me numër protokoll 2021/DSF/138, për Drejtorin e

Përgjithshëm të Aviacionit Civil të Kosovës për lëshimin e kredencialeve të Inspektore. Ankuesja për shkak të heshtjes administrative nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës lidhur me kërkesën e datës 23.04.2021, ka parashtruar ankesë me datën 18.06.2021 me numër protokolli 3166/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.06.2022 ka nxjerr Vendim A.nr.559/2021 me të cilin ka detyruar Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës të bëjë shqyrtimin e kërkesës së ankueses.

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, më datë 12.07.2022 përmes përgjigjes me email ka njoftuar ankuesen se në bazë të dispozitave ligjore në fuqi nuk mund të bëhet emërimi në pozitë të Inspektore pa procedurë dhe pa qenë pozita e paraparë në organizimin e brendshëm të institucionit.

Ankuesja kundër kësaj përgjigje, më datë 21.07.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 4233/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të cilën më datë 01.08.2022 e ka plotësuar, me pretendimet për shkelje ligjore dhe procedurale.

Për shkak të specifikave dhe kompleksitetit të lëndës, më datë 26.08.2022 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr Vendim me numër VK.nr.86/2022 me të cilin ka bërë vazhdimin e afati për vendimmarrje edhe për dhjetë ditë punë për ankesën e ankueses.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:4233/2022 të datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 19.08.2021; Akt Emërimit e datës 29.05.2015 dhe 23.12.2016; Rekomandimin për emërimin e ankueses në pozitën Inspektore e Aviacionit të Përgjithshëm e datës 20.01.2020; Rekomandimin për lëshimin e kredencialeve për ankueses i datës 15.07.2020; Certifikatën e datës 20.04.2021; Certifikatën për periudhën 11 dhe 11,11.2019; Certifikatën nga CEAC; Certifikatën për periudhën 26-28.10.2015; Certifikatën nga JAA e datës 08.11.2021; Certifikatën nga 26-30.01.2015; Certifikatën me Nr.46195; Certifikatën për periudhë 01-03.06.2022; Certifikatën me Nr.47267; Përshkrimi i përgjithshëm për Inspektore e Aviacionit të Përgjithshëm datës 20.01.2020; Formulari i vlerësimi për inspektor i datës 15.02.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për Zyrtare e Aviacionit të Përgjithshëm i datës 20.12.2019, 18.01.2021; Kërkesë për lëshimin e kredencialeve të Inspektore e datës 23.04.2021 nga ankuesja; Ankesën e datës 18.06.2021 nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 02.08.2021; Vendimin A.nr.559/2021 të datës 28.06.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 12.07.2022 nga për ankuesen; Shkresë për delegimin e inspektor të aviacionit të përgjithshëm për ankuesë datë 20.01.2020; Shkresë me titull audit report e datës 08.04.2019; Raportin për mbylljen e ndodhive të raportuara të sulmeve me laser nga ankuesja i datës 22.10.2019; Kërkesë për nënshkrim të lejes për operim GAT/VFR e datës

16.04.2021; Raportin e Avokatit të Popullim A.nr.474/2021 i datës 09.06.2022; Shkresë me titull Diskriminimi gjinor në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës i datës 07.07.2022; Shkresë me titull Shkelje e detyrave profesionale nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC e datës 13.05.2022; Emailin e datës 19.04.2021 nga ankuesja; Raportin Javor të punës së Inspektorit datë 27.12.2019, 15.08.2019; Emailin e datës 01.10.2020 nga Emailin e datës 28.12.2019, 26.12.2019 nga ankuesja; Emailin e datës 27.12.2019 nga Emailin e datës 27.12.2019, 30.12.2019, 26.12.2019 nga Emailin e datës 08.08.2017 nga GAT; Emailin e datës 10.08.2017 nga Aeronautical Information Service; Emailin e datës 21.07.2017 nga Emailin e datës 11.02.2019 nga GAT; Emailin e datës 07.08.2012 nga Emailin e datës 13.07.2022 nga GAT; Emailin e datës 16.04.2021 nga Emailin e datës 27.07.2017; Emailin e datës 24.07.2017 nga ankuesja; Emailin e datës 11.11.2016, 15.11.2016 nga GAT; Emailin e datës 1.02.2019 nga Emailin e datës 28.06.2019 nga BAZANTJ; Emailin e datës 15.07.2020 nga GAT; Raporti javor i punës së Inspektorit datës 25.10.2019, 15.11.2019; Emailin e datës 16.03.2022 nga ankuesja; Emailin e datës 23.04.2021 nga Emailin e datës 08.02.2021 nga Emailin e datës 22.01.2021 nga Emailin e datës 22.01.2021 nga Emailin e datës 22.01.2021 nga Emailin e datës 21.01.2021 nga Emailin e datës 21.02.2021 nga Raportin e punës për periudhën javore datës 21.03.2022; Emailin e datës 20.11.2020 nga Kërkesë për nënshkrim të lejes për operim GAT/VFR e datës 16.04.2021, 30.10.2020, 16.11.2020; Rapoeti i punës i datës 19.04.2021; Emailin e datës 16.04.2021 nga Emailin e datës 15.04.2021, 14.04.2021 nga Emailin e datës 13.04.2021 nga Emailin e datës 23.08.2022 nga Lista e Inspektorëve të AAC-s Pranimi-dorëzimi i kredenciales 31.05.2022; Vendimin me Nr. Ref:31/2022 të datës 22.06.2022; Formular aplikimi për aprovimin dhe regjistrim të sistemit të mjetit ajror pa pilot nga Kërkesën për nënshkrim të Aprovimit për Regjistrim të Dronit (SAP) datës 27.07.2022; Certifiakte për Test teorik i njohurive për operim me Sisteme të Mjeteve ajrore pa pilot (SAP) i datës 22.07.2022 për Emailin e datës 20.07.2022 nga Certifiakte për e datës 19.10.2020; Emailin e ankueses e datës 20.10.2020 për Emailin e datës 12.10.2020 për Certifikatën Shëndetësore për Emailin e datës 01.10.2020 nga Test teorik i njohurive për operim me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (SAP) i datës 09.10.2020 për Raporti Javor i punës së Inspektorit i datës 01.11.2019, 15.11.2019, 20.12.2019, 27.12.2019; Emailin e datës 02.03.2020, 20.02.2020, 04.03.2020 nga ankuesja për Emailin e datës 20.02.2020, 04.03.2020 nga për ankuesen; Emailin e datës 29.01.2020 nga Drones; Emailin e datës 04.08.2020, 03.08.2020 nga ankuesja për Vendimin VK.nr.86/2022 të datës 26.08.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës të nxjerr akt administrativ, *sepse*:

Gjatë shqyrtimit të provave të lëndës si dhe pretendimeve ankimore të ankuese, Kolegji i Këshillit ka konstatuar së Përgjigja e datës 12.07.2022 e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës është kundërthënëse me vet përmbajtjen e saj dhe së me të njëjtën nuk është trajtuar kërkesa e ankuses e datës 24.03.2021 ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, rrjedhimisht Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës nuk ka nxjerr akt administrativ me të cilin përveç që palës do t'i epet mundësia të kontestoj një akt administrativ, po ashtu do të sigurohej mundësia e palës që ta kuptojë aktin administrativ, sepse në bazë të përgjigjes së datës 12.07.2022 pala nuk ka arritur të marr përgjigje konkrete.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, në bazë të të gjitha fakteve lidhur me këta çështje, konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, si autoritet aprovues për dhënien e kredencialeve siç parashihet me Rregulloren Nr.08/2011 për Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektorëve, gjegjësisht me nenin 5 ku përcaktohet se: "Drejtori i përgjithshëm është autoriteti aprovues për dhënien e kredencialeve. Departamenti i Administratës do të administrojë procesin e lëshimit dhe kontrollit të kredencialeve të lëshuara", në bazë të përgjigjes së datës 12.07.2022 përveç që nuk ka nxjerrë aktin administrativë siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, në lidhje me kërkesën sipas përgjigjes së datës 12.07.2022 nuk ka arrit të arsyetoj bazën ligjore sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011 për Procedurat e Lëshimit të Kredencialeve të Inspektorit, e në këtë formë duke mos vërtetuar faktin që ankuesja a i ka plotësuar kushtet juridike-formale për dhënien e kredencialeve siç parashihet me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje dhe poashtu duke mos sqaruar edhe rrethanën se e njëjta mbi çfarë baze ligjore i ka ushtruar zyrtarisht këto përgjegjësi nga se nga shkresat e lëndës vërtetohet fakti se e njëjta i ka ushtruar këto përgjegjësi për një periudhë.

Ndërlidhur me arsyetimin e dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në përgjigjen e datës 12.07.2022 se dhënia e kredencialeve të Inspektorit paraqet detyrim për ndryshimin e aktit të emërimit, Kolegji i Këshillit vlerëson se janë të paqëndrueshme, ngase akt i emërimit në kuptim të nenit 32 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë lëshohen me qëllim të themelimit të marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, ndërsa kredencialet e inspektorit në kuptim të nenit 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011 për Procedurat e Lëshimit të Kredencialeve të Inspektorit e kanë kuptimin e dhënies apo njohjes të së drejtës për kryerjen detyrave të veçanta mbikëqyrjeje nën kushtet dhe kriterët e parapara për nëpunësit e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës të cilët veçse e kanë të themeluar marrëdhënien e punës, rrjedhimisht procesi i aktemrimeve në këtë aspekt ndërlidhet me strukturën organizative të institucionit, nëse pozita të tilla të inspektorëve ka të lira brenda institucionit atëherë konformë legjislacionit në fuqi që është zbatuar me rastin e dhënies së aktemrimeve të inspektorëve të tjerë të këtij institucioni sipas të njëjtës formë duhet të aplikohet standardi i njëjtë me qëllim që të mos ketë elemente të diskriminimit për ndonjë zyrtarë të caktuar për faktin se kemi të bëjmë me investim profesional dhe financiar nga institucioni i njëjtë

në proces të dhënies së kredencialeve të inspektorit dhe me aprovim të zyrtarit kryesor administrativë të institucionit, nga se gjatë vizitës që kemi bërë në këtë institucion për të qartësuar disa elemente të kësaj natyre është vërtetuar fakti se inspektorët e këtij institucioni marrëdhënien e punës në këtë institucion e kanë të themeluar në pozita tjera e pastaj përmes procesit të ngritjes profesionale-trajnimeve me aprovime paraprake të eprorëve i kanë marrë edhe kredencialet e pastaj ju kanë ndërrue edhe aktemrimet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, thekson faktin se Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës ka obligim ligjor të vepror konformë këtij vendimi duke sqaruar çdo dilemë që është shfaqur sa i përket kësaj çështje që është objekt i kësaj ankese dhe në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Rregulloren Nr.08/2011 për Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektorëve dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2011 për Procedurat e Lëshimit të Kredencialeve të Inspektorit, është i obliguar që të nxjerr akt administrativ në pajtim me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative dhe të arsyetuar në pajtim me nenin 48 të këtij ligji dhe në të njëjtën kohë të shqyrtoj të gjitha pretendimet e palës si në kërkesën e datës 23.04.2021.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.645/2022, datë 16.09.2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

